



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazni

Nr. 1/48
Br. 1/48

Data 28.09.2023
Datum 28.09.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të kërkesës nga Reis Sallova, nga komuniteti i Lagjes "Washingtoni" nr. -I-9584/23, e dt.07.04.2023, pas sqarimit të drejtorit të DPUKP-së, me nr.-V-442, të dt.28.04.2023, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Caktohet lokacioni i ri për ri vendosjen e Tregut në Njësinë Kadastrale nr.P-72614055-01885-0, me sipërfaqe prej 5801 m² e cila evidentohet në emër të Komunës së Obiliqit, e cila në anën veri lindore ka qasje në rr: "Mentor Dervishaj" ndërsa në anën veri perëndimore ka qasje në rr: "30 Marsi".
2. Zhvendosja e Tregut bëhet nga lokacioni aktual në lokacionin e ri me qëllim që banorët të kenë qasje në rr: "Washingtoni".
3. Meqë, "Infrakosi" është duke bërë revitalizimin e Hekurudhës, e cila atakon Komunën tonë, në këtë pjesë përballë Tregut ekzistues planifikohet ndërtimi i një nënkalimi, i cili iu mundëson qasje në rr: "Washingtoni" qytetarëve të cilët banojnë në anën tjetër të hekurudhës.
4. Investitori i objekteve banesore do të bartë të gjitha shpenzimet e lirimit të parcelës ekzistuese (Tregut dhe një objekti të pashfrytëzueshëm që gjendet afër Tregut) dhe po ashtu do të bartë të gjitha shpenzimet për vendosjen e Tregut në lokacionin e ri të caktuar nga Kuvendi Komunal brenda për brenda dimensioneve ekzistuese.
5. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit



Kryesuese e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi
Vlora Mjekiqi Kabashi